



# Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada - Government*

*Zyra e Kryeministrit - Office of the Prime Minister*

---

## Raporti mbi Arritjet dhe Sfidat në Zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit

Dorëzuar nga:

Qeveria e Republikës së Kosovës  
në takimin e dytë të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit mes  
Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës  
Grupi i veçantë për normalizim

*Bruksel, 18 Qershor 2018*

## Përmbajtja

<b>ZBATIMI I MARRËVESHJES SË PARË (PRILL 2013) DHE MAJ 2015 - PLANI I ZBATIMIT</b>	
<b>- MARRËVESHJE PËR ENERGINË DHE TELEKOMIN.....</b>	<b>3</b>
Zgjedhjet.....	3
Asociacioni/Komuniteti i Komunave me shumicë Serbe në Kosovë.....	4
Policia .....	6
Drejtësia.....	7
Mbrojtja Civile .....	10
Aranzhimet ndërlidhëse (Liaison Arrangements).....	12
Marrëveshja për Energji .....	13
Marrëveshja për Telekomunikacionin .....	16
<b>PUNA PËR ZBATIM NË PERIUDHËN MARS 2011 - SHKURT 2012 NË LIDHJE ME</b>	
<b>MARRËVESHJET E DIALOGUT TEKNIK.....</b>	<b>18</b>
Çështjet doganore .....	18
MIK-u dhe pikat e përbashkëta të kalimit kufitar .....	21
<b>Liria e lëvizjes.....</b>	<b>25</b>
Liria e lëvizjes/Ura e Mitrovicës.....	28
Për bashkëpunimin rajonal.....	30
Njohja e diplomave universitare .....	31
Mbi kadastrën.....	34
Bashkëpunimi me EULEX-in Kosovë .....	36

## ZBATIMI I MARRËVESHJES SË PARË (PRILL 2013) DHE MAJ 2015 - PLANI I ZBATIMIT - MARRËVESHJE PËR ENERGJINË DHE TELEKOMIN

### Zgjedhjet

#### *Progresi*

Qeveria e Kosovës (QeK) e mbështet zbatimin e marrëveshjes për zgjedhjet komunale të vitit 2017 (4 gusht 2013). Zgjedhjet lokale (22 tetor 2017) dhe inaugurimi i organeve të sapo zgjedhura në të gjitha komunat e Kosovës paraqet arritjen e një progresi të konsiderueshëm. Pas zgjedhjeve të para lokale, prapë u mbajtën zgjedhjet duke përfshirë katër komunat veriore me shumicë serbe. Nën organizimin e Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), këto zgjedhje u mbajtën sipas ligjit të Kosovës dhe në përputhje me marrëveshjen e Brukselit. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) ka ofruar mbështetje teknike për zgjedhjet në komunat veriore, dhe ka certifikuar zgjedhjet. Edhe organizatat e tjera ndërkombëtare, siç është Misioni vëzhgues i BE-së, i kanë certifikuar zgjedhjet. Duhet përmendur se subjektet politike në veri janë regjistruar dhe certifikuar nga KQZ-ja. Lista e votuesve është certifikuar nga Regjistri Civil i Kosovës.

#### *Sfidat*

Dalja në votime në komunat veriore ishte mesatare, marr parasysht tranzicionin politik nga bojkoti i plotë drejt pjesëmarrjes në zgjedhje nga ana e qytetarëve serbë në veri. Ka pasur disa incidente të dhunshme nga Serbët kundër subjekteve politike serbe të cilat konsideroheshin si jo-besnike ndaj Qeverisë së Serbisë. Ankesat janë trajtuar nga Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa.

## Asociacioni/Komuniteti i Komunave me shumicë Serbe në Kosovë

### *Progresi*

Pas marrëveshjes mbi parimet e përgjithshme për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe në Kosovë (AKS), në vitin 2015 Presidenti i Kosovës e dërgoi marrëveshjen para Gjykatës Kushtetuese për të vlerësuar nëse e njëjta ishte në përputhje me Kushtetutën e Kosovës. Gjykata Kushtetuese (KO 130/15, 23 dhjetor 2016) konstatoi se disa nga dispozitat e marrëveshjes sa i përket strukturës dhe funksionimit të AKS nuk ishin në përputhje me kushtetutën. Gjykata konstatoi se statuti i AKS duhet të jetë në pajtueshmëri me Kushtetutën. Qeveria e Kosovës mbetet e zotuar në zbatimin e marrëveshjes për AKS, në përputhje me vendimin e gjykatës kushtetuese. Në vitin 2016, QeK krijoi një ekip menaxhuese të cilit ju bashkuan edhe dy anëtar të ri që plotësuan pozitën e lëna boshe nga anëtarët e mëparshëm që kishin marrë poste të tjera publike. Ky ekip i ri ishte më përfaqësues meqenëse i përfaqësonte gjitha dhjetë komunat me shumicë serbe, për dallim nga ekipi i mëparshëm që përfaqësonte vetëm katër komunat e veriut. Në vitin 2018, Kryeministri i Kosovës dhe Presidenti, në përputhje me vendimin e gjykatës kushtetuese, ri-aktivizuan ekipin menaxhues me përgjegjësitë e hartimit të statutit të Asociacionit të komunave me shumicë serbe. QeK do të krijojë edhe komisionin për zbatimin e AKS dhe grupin kombëtar konsultativ për AKS, të cilët do të përfshihen në hartimin e statutit, e i cili do të shqyrtohet edhe nga Gjykata Kushtetuese. Qeveria do të organizojë edhe konsultime publike me qytetarët të cilët preken drejtpërdrejt nga marrëveshja e AKS.

### *Sfidat*

Partitë opozitare e kundërshtuan fuqishëm AKS. Të gjitha partitë i kundërshtojnë të ashtu quajturat kompetenca ekzekutive të AKS. Do të jetë sfiduese që të arrihet ekuilibrimi mes kërkesave të përcaktuara nga Gjykata Kushtetuese dhe interesave të komunitetit Serb. QeK inkurajon të gjithë anëtarët e ekipit menaxhues që të diskutojnë në lidhje me autoritetin e AKS. Qeveria e mbështet një proces gjithëpërfshirës dhe transparent të hartimit të statutit të AKS, që do të përfshinte të gjitha partitë politike, organizatat e shoqërisë civile të popullsisë shqiptare dhe atyre serbe, përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar, si dhe palët e tjera të interesit. Statuti i AKS duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën dhe vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Drafti i statutit do të dorëzohet për shqyrtim nga Gjykata.

Disa përfaqësues të komunitetit Serb kanë sugjeruar themelimin e njëanshëm të AKS si strukturë paralele. Veprimet e njëanshme janë provokative dhe mund të rezultojnë me jo-stabilitet dhe dhunë. QeK në mënyrë të zëshme kundërshton çfarëdo hapi për themelimin e njëanshëm të AKS. QeK i kundërshton nxitjet nga Serbia që të cenojnë integritetin territorial të Kosovës nën maskën e AKS.

Qeveria e Kosovës (QeK) është plotësisht e zotuar për themelimin e AKS, dhe pret që Serbia të shpërbëjë strukturat e saj paralele në Kosovë. QeK ka njoftuar BE-në dhe partnerët e tjerë ndërkombëtar për kundërshtimin e saj të fuqishëm ndaj strukturave paralele. Kosova pret që BE dhe përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar t'i kërkojnë Serbisë që të ndal mbështetjen dhe të shpërbëjë të gjitha strukturat paralele.

## Policia

### *Progresi*

Marrëveshja e 19 prillit \_\_\_\_\_ me ndërmjetësim nga BE-ja, pasqyron mirëkuptimin mes dy Kryeministrave dhe inkorporon qëndrimet teknike të grupit të sigurisë të delegacionit të Kosovës. QeK ka kënaqësinë të raportoj si në vijim:

- Është zbatuar plotësisht Marrëveshja për integrimin e Policisë së Kosovës (PK);
- Është miratuar infrastruktura ligjore për krijimin e DRP Mitrovica dhe emërimin e Drejtorit Rajonal në Drejtorin Rajonale të Policisë në Mitrovicën Veriore (Udhëzimi Administrativ);
- Është krijuar DRP i Mitrovicës Veriore;
- Është emëruar Ushtruesi i Detyrës së Drejtorit Rajonal në DRP të Mitrovicës Veriore (25 qershor 2013);
- Integrimi i anëtarëve të MUP-it është bazuar në shqyrtimin e procedurave dhe rregullimin e dokumenteve siç është formulari i aplikimit dhe kontrata e punës;
- Është arritur plotësimi i stafit në njësit rajonale të DRP të Mitrovicës Veriore si dhe është emëruar stafi komandues;
- Gjithsej numri nga lista e MUP arrin në 337. Pas verifikimi të së kaluarës janë aprovuar 292 persona. Prej tyre, 5 janë tërhequr nga procesi i integritetit duke e ndërprerë trajnimin.
- PK ka promovuar 6 major dhe 17 togerë duke u bazuar në marrëveshjen e datës 01.08.2014;
- Është duke vazhduar trajnimi i zyrtarëve policor.

### *Sfidat*

Serbia është dashur të siguroj një listë që tregon hollësisht numrin dhe gradën e punonjësve qeveritar serb (policë) të punësuar në Kosovë, të cilët kanë shprehur interesimin që t'i bashkohen strukturave të Kosovës (që nga 13 qershor i vitit 2013). Megjithatë, dorëzimi i listës ishte vonuar (deri më 11 dhjetor 2013).

Pas krijimit të ekipit menaxhues, Serbia i siguroi emrat e dy kandidatëve për pozitën e ushtruesit të detyrës së Komandantit Rajonal të Policisë (KRP). Pas verifikimit të së kaluarës që të dy kandidatët u refuzuan. Kandidati i parë ishte vetëm anëtar i MUP dhe asnjëherë nuk kishte shërbyer në kuadër të PK, ndërsa kandidati i dytë ishte shkarkuar nga PK para tre vitesh dhe kishte dosje penale për falsifikim dokumentesh.

Emërimi i stafit të lartëmenaxhuese për Drejtorinë Rajonale të Policisë në veri duhet të jetë në përputhje me përfundimet;

Sfidat e vazhdueshme janë dokumentet e identifikimit, kontratat e punës, deklaratat profesionale, betimi në detyrë dhe sistemi i gradimit.

## Drejtësia

### *Progresi*

Marrëveshjet në fushën e drejtësisë bazohen në paragrafin 10 të Marrëveshjes së Parë të Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve si dhe Protokollit për Zbatimin e Menaxhimit të Integruar të Kufijve. Marrëveshja e arritur në prill të vitit 2013 për normalizimin e marrëdhënieve i kërkon QeK që me ndihmën e EULEX të themeloj mekanizma përkatës gjyqësor dhe prokurorial në Mitrovicën Veriore brenda një periudhe të caktuar kohore dhe në përputhje me ligjet e Kosovës. Në kuadër të përfundimeve parashihet një gjykatë dhe një prokurori themelore në Mitrovicë, me departamente të vendosura në objekte të Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës Veriore. Gjykata Themelore në Mitrovicë do të ketë degë të saj në rajonin e Mitrovicës (Zubin Potok, Leposaviq, Skenderaj dhe Vushtrri). Përveç kësaj, kjo marrëveshje përcakton metodën e ndarjessë rasteve, numrin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe përkatësinë e tyre etnike e tyre dhe faktorë të tjerë. Marrëveshja e Drejtësisë (shkurt 2015) përcakton numrin, përzgjedhjen dhe mënyrën e emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Gjithashtu, ajo specifikon përkatësinë etnike të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe metodat për trajtimin e rasteve.

42 gjyqtar kanë bërë betimin dhe kanë marrë pozitat (3 prej tyre kanë dhënë dorëheqje);

- Janë rekrutuar 13 prokuror dhe 106 anëtar të stafit administrativ;
- Gjyqtarët dhe prokurorët janë duke u trajnuar nga Akademia e Drejtësisë, në mënyrë që të familjarizohen me legjislacionin e RKS;
- Rastet janë duke ju ndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve. Rreth 2,500 raste janë në pritje, prej të cilave 70% janë çështje civile.

Takimet e dialogut në shkurt të vitit 2018 kanë identifikuar çështje të ndryshme sa i përket zbatimit të marrëveshjes për drejtësinë, me theks të veçantë në lidhje me konkurset për gjyqtar mbikëqyrës në Shtërpçë, Novobërdë dhe Zubin Potok (KGJK). Këto pozita janë plotësuar si vijon:

- a. Dega në Shtërpçë - Z. Musa Konxheli është Gjyqtar Mbikëqyrës me mandat deri më 15 mars të vitit 2021;
- b. Dega në Novobërdë - Znj. Emine Salihu është Gjyqtare Mbikëqyrëse me mandat deri më 29 maj 2022;
- c. Dega në Zubin Potok - Z. Petronije Bozovic është Gjyqtar Mbikëqyrës me mandat deri më 18 gusht të vitit 2018; dhe
- d. Dega në Leposaviq - Znj. Bojana Trboljevac është Gjyqtare Mbikëqyrëse me mandat deri më 06 qershor të vitit 2019.

Sa i përket pozitave të lira për plotësimin e numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve (KGJK), janë aprovuar 450 gjyqtar. Aktualisht 399 gjyqtar janë duke punuar në sistemin

gjqësor. Janë edhe 51 pozita të lira. Rekrutimi është duke vazhduar për 37 pozita. Gjithashtu, janë ndërmarr hapa për të plotësuar vendet e lira për Profesionet e lira në veri të Kosovës (MD). Hapa janë ndërmarr për adresimin e çështjes së përkthimit të materialeve dhe interpretimit për stafin gjyqësor dhe prokurorial (KGJK dhe KPK). Këshilli Gjyqësor i Kosovës parasheh 5 pozita për përkthyes në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, të cilat do të plotësohen së shpejti. Për më tepër, GIZ do të financoj 4 pozita të përkthyesve për Gjykatën Themelore në Mitrovicë, të cilat do të ekzistojnë deri në fund të vitit 2018. KGJK do të përqendrohet në rritjen e numrit të përkthyesve në vitin 2019.

Sekretariati ka angazhuar 33 anëtar të stafit administrative nga komuniteti serb që të punojnë në zyrën e prokurorisë. Të gjithë, përveç njërit, vazhdojnë të punojnë. Këto pozita përfshijnë zyrtar ligjor, sekretar të ligjore, zyrtarët financiar, teknikë të teknologjisë së informacionit, arkivist, shofer dhe shkrimoren e gjykatës.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, në bazë të respektimit të identitetit gjuhësor të të gjithë personave dhe me qëllim të krijimit të një mjedisi të përshtatshëm të punës për të gjitha komunitetet, Këshilli deri tani ka punësuar 4 përkthyes në kuadër të Prokurorisë Themelore të Mitrovicës. Në vitin 2019 do të punësohen edhe 5 përkthyes të tjerë.

Në dhjetor të vitit 2017, Akademia e Drejtësisë përfundoi Programin e Trajnimit Fillestar në fushën e drejtësisë penale dhe civile dhe kompetencat ndërdisiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të cilët janë integruar. Trajnimi intensiv fillestar për gjyqtarë dhe prokurorë të shtetit u realizuar për 11 ditë. Trajnimi ka synuar të ngrit kapacitetet e gjyqtarëve dhe prokurorëve për kryerjen e punës dhe marrjes së vendimeve të drejta. Gjithashtu, trajnimi u përqendrua që të ndihmoj gjyqtarët dhe prokurorët e integruar që të familjarizohen me parimet themelore të legjislacionit të Kosovës. Gjyqtarët dhe prokurorët kanë ndjekur gati se të gjitha trajnimet e vazhdueshme në Akademinë e Drejtësisë gjatë vitit 2018. Gjyqtarët e integruar janë duke ndjekur edhe kurset e detyrueshme të përqendruara në etikën profesionale. Trajnimi fillestar prej 12 muajve është i detyrueshëm për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e sapo emëruar. Pesë gjyqtar dhe dy prokuror janë duke ndjekur këto trajnime. Për më tepër, gjyqtarët e sapo integruar janë duke ndjekur edhe trajnimet fillestare për gjyqtar. Programi i trajnimit është përgatitur nga Këshilli dhe Akademia e Drejtësisë. Ky program ka adresuar shkathtësitë dhe praktikën e funksionit të prokurorit të shtetit në trajnimin e paanësisë, vlerave, sjelljeve të duhura brenda dhe jashtë zyrës së prokurorisë, etikën profesionale, shkathtësitë të procedurës gjyqësore dhe vendimmarrje, zbatimin e praktikave më të mira si dhe familjarizimin me ndryshimet dhe risit në legjislacion. Dy prokuror janë duke ndjekur trajnimin fillestar prej 12 muajve. Prokurorët e tjerë marrin pjesë në trajnimet e vazhdueshme që organizohen nga Akademia e Drejtësisë. Ata trajnohen në tema specifike sipas nevojave të tyre.



Ndarja e rasteve për gjyqtar bëhet përmes shortit. Ndarja sipas shortit bazohet në numrin e gjyqtarëve dhe volumin e rasteve të reja të ardhura, pa marr parasysh ngarkesën me lëndë për secilin gjyqtar. Këshilli Gjyqësor i Kosovës është duke e adresuar këtë çështje në komisionin përkatës dhe së shpejti do dali me një rekomandim për përmirësimin e mënyrë së ndarjes së lëndëve. Ndarja e rasteve sipas sistemit të rastësisë (shortit) bazohet në numrin e prokurorëve, volumin e rasteve të ardhura, pa marr parasysh ngarkesën me lëndë për secilin prokuror. Shorti organizohet nga Kryeprokurori i Zyrës përkatës të prokurorisë, dhe të gjithë prokurorët ftohen që të marrin një numër përmes të cilit i ndahen rastet.

Protokolli për zbatimin e MIK i arritur në vitin 2012, parasheh bashkëpunimin juridik ndërkombëtar që realizohet përmes shkëmbimit të letrave mes bashkë-koordinatorëve (janar 2013, e amendamentuar në 2015). Bashkëpunimi juridik me Serbinë është duke vazhduar.

Gjatë periudhës Janar-Qershor 2018, zbatimit i Protokollit të MIK mbi Ndihmën e Ndërsjellë Juridike rezultoi me mbi 62 kërkesa nga e Serbisë për Kosovën, të cilat u adresuan në 48 raste, ndërsa nga 326 kërkesat e dërguara nga pala Kosovare, pala serbe është përgjigjur në 258 raste.

### *Sfidat*

Për shkak të pamundësisë që të komunikoj drejtpërdrejt me autoritet serbe, QeK i dërgon kërkesat e saj përmes Zyrës së Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë. Që nga tetori i vitit 2014, kërkesat e QeK për asistencë juridike në çështje civile dhe penale janë dërguar përmes EULEX-it.

Serbia i vulos dokumentet me mbishkrimin: “Republikae Serbisë - Kosova dhe Metohija-nën administrimin e OKB-së dhe Rezolutës 1244”. Kjo vulë vendoset në dokumentet origjinale të gjykatave dhe organeve të tjera të Kosovës. QeK ka shprehur shqetësimet e saj në lidhje me vulat, megjithatë autoritet serbe vazhdojnë të vendosin këto vula mbi dokumentet e tilla.

## Mbrojtja Civile

### *Progresi*

Qeveria e Kosovës, në pajtim me marrëveshjen e vitit 2013 lidhur me parimet që rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve, ka ndërmarrë masa për integrimin e pjesëtarëve të mbrojtjes civile serbe në institucionet e Kosovës, si dhe ka siguruar burimet dhe trajnimet e nevojshme. QeK ka miratuar Vendimin 06/39 (i datës 22.07.2015), i cili ka paraparë shpërbërjen e mbrojtjes civile dhe ka kërkuar që të gjitha institucionet relevante të ndajnë burimet e nevojshme për integrimin e pjesëtarëve të mbrojtjes civile.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) ka lehtësuar integrimin e pjesëtarëve të mbrojtjes civile serbe në institucionet e Kosovës. MAPL ka mbajtur 25 takime me ministri dhe agjenci të ndryshme qeveritare. Si rezultat i kësaj, grupi i parë prej 483 pjesëtarëve - prej të cilëve vetëm 25 janë femra - janë integruar në ministrinë dhe agjencitë e Qeverisë së Kosovës. Ministri për Dialog i Kosovës ka nxjerrë udhëzime për integrimin e pjesëtarëve të mbrojtjes civile, si dhe ka dhënë udhëzime për procesin e aplikimit, përzgjedhjes dhe kontraktimit. Këta 483 persona të integruar janë përzgjedhur në bazë të shprehjes së interesit, arsimit dhe përvojës së tyre profesionale. Secili institucion ka ndarë fonde për të integruar këta persona, dhe të gjithë këta 483 persona kanë nënshkruar kontrata me institucionin në të cilin ata janë integruar. Në korrik të vitit 2016, grupi i dytë i përbërë prej 50 personave është integruar në 17 institucione qendrore. Ceremonia e integritit është mbajtur në ndërtesën komunale të Mitrovicës së Veriut.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Administratë Publike, Akademinë e Policisë së Kosovës dhe me mbështetjen e OSBE-së, ka trajnuar të gjithë pjesëtarët e integruar. Qëllimi i trajnimit ka qenë që të sigurohet një orientim për legjislacionin dhe institucionet e Kosovës dhe përgatitjen e personave të integruar që të ushtruar funksione në kuadër të institucioneve të Kosovës.

Pas zgjedhjeve të vitit 2017, qeveria e re ka vazhduar përpjekjet për të forcuar shërbimin civil në komunat e veriut. Me kërkesë të komunës së Zveçanit, Kryeministri ka nxjerrë Vendimin 193/2017 (i datës 15.11.2017) për të hequr nga lista e pagave 172 nëpunës civilë, të cilët kanë qenë në listën e pagave të buxhetit special të qeverisë para marrëveshjes së vitit 2013. Vendimi gjithashtu i ka lejuar komunës së Zveçanit që të plotësojë pozitat në përputhje me ligjet e Kosovës. Një kërkesë e ngjashme është parashtruar edhe nga komuna e Leposaviqit, ndërsa pritet edhe vendimi i Kryeministrit.

### *Sfidat*

Megjithësekëta 483 persona të integruar kanë kontrata me institucionet e Kosovës, në praktikë ata nuk i ushtrojnë funksionet e tyre në pajtim me ligjet e Kosovës. Personat e integruar nuk janë të përgjegjshëm dhe nuk i raportojnë institucioneve të Kosovës. Personat e integruar nuk kanë objekte, materiale apo zyre për të kryer detyrat e tyre. Ka mungesë bashkëpunimi në nivel sektorial ndërmjet institucioneve të Kosovës dhe personave të integruar.

Në vitin 2017, sulmi me bombë në zyrat e reja të QeK-së u përshkua me tensione në komunat veriore. Sfidat lidhur me lirinë e lëvizjes, vazhdimi i ekzistencës së strukturave paralele dhe mungesa e komunikimit efektiv ndërmjet personave të integruar dhe institucioneve të Kosovës paraqesin sfida të rëndësishme.

Gjithashtu u hasën sfida në integrimin e 39 pjesëtarëve të stafit administrativ nga 71 sosh të policisë paralele serbe (ish "MUP") në zyrat e gjendjes civile në katër komunat veriore. MAPL ka përfunduar përgatitjet e nevojshme për integrimin e këtyre pjesëtarëve të stafit në strukturat komunale, duke përfshirë lehtësimin e procesit të ndarjes së buxhetit. Megjithatë, komunat veriore kanë refuzuar integrimin e 39 pjesëtarëve të stafit administrativ në strukturat komunale.

Për adresimin e këtyre sfidave, QeK angazhohet në:

- Forcimin e autoriteteve të sundimit të ligjit për të hetuar, ndjekur penalisht dhe gjykuar krimin e organizuar, aktet e dhunës, kërcënimet dhe frikësimet;
- Rritjen e koordinimit ndërmjet institucioneve në nivel qendror dhe stafit të integruar, duke përfshirë vlerësimet e performancës dhe zbatimin e detyrimeve dhe përgjegjësiive kontraktuale;
- Ofrimin e trajnimeve të rregullta për stafin e integruar, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre për ligjet e Kosovës, si dhe trajnimeve specifike në sektorët në të cilët ata janë të përfshirë;
- Ndërtimin e objekteve për zyra, për stafin e integruar, si dhe pajisjen e objekteve me infrastrukturë adekuate;
- Kërkesën për të qenë në pajtueshmëri në katër komunat veriore, duke integruar neper komuna 39 pjesëtarët e stafit administrativ, nga 71 sosh.

## Aranzhimetndërlidhëse (Liaison Arrangements)

### *Progresi*

Krijimi i aranzhimeve për ndërlidhje ose më mirë thënë Zyrat Ndërlidhëse, janë rezultat i suksesshëm i dialogut. Përfaqësuesit e QeK-së janë të pranishëm në Serbi në mënyrë permanente dhe kanë arritur të zgjerojnë fushëveprimin e aktiviteteve të tyre. Puna më e dukshme e Zyrës Ndërlidhëse përfshin vizitat zyrtare. Komunikimi me Zyrat Ndërlidhëse asnjëherë nuk është ndërprerë. Puna ka përparuar në çështjet që ndikojnë në jetën e qytetarëve të zakonshëm. Deri më tani, që nga marrëveshja për vizitat zyrtare (e datës 14 nëntor 2014), janë organizuar 227 vizita. Vetëm 13 kërkesa për vizitë janë refuzuar, duke përfshirë edhe njoftimet e përsëritura për të njëjtën vizitë (d.m.th. vendi, data dhe zyrtarët e njëjtë). Prej 1 qershorit 2017 e deri më tani janë organizuar 23 vizita, dhe vetëm 2 sosh janë refuzuar (z. AleksandarVulin, Ministër i Mbrojtjes në Qeverinë e Serbisë dhe z. Marko Djurić, Drejtor i Zyrës për Kosovën pranë Qeverisë së Serbisë). Gjatë kësaj periudhe, nga zyrtarët e lartë të Qeverisë së Serbisë janë anuluar gjashtë vizita të miratuara, për arsye të panjohura për ne. Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar 13 vizita të qytetarëve të Serbisë. Patriarku i Kishës Ortodokse Serbe ka vizituar Kosovën në prill të vitit 2018 pa dërguar njoftim. Me udhëzimet e kryeministrit të Republikës së Kosovës, z. RamushHaradinaj, për hyrjen e Patriarkut Irinej dhe anëtarëve të delegacionit të tij nuk iu është kërkuar as letërnjoftimi e as pasaporta.

### *Sfidat*

Pavarësisht kontaktit me autoritetet serbe, nuk është realizuar potenciali i plotë i zyrave të ndërlidhjes. Që nga tetori i vitit 2015, nuk janë zbatuar marrëveshjet për zgjerimin e stafit të Zyrave Ndërlidhëse. QeK beson se një staf më i madh do të kishte ndikim cilësor në funksionimin e Zyrave Ndërlidhëse. Nuk ka marrëveshje për përdorimin e logove dhe vulave të dokumenteve zyrtare nga ZN-të.

## Marrëveshja për Energji

Asnjë përparim nuk është shënuar në zbatimin e Marrëveshjeve për Energjinë dhe Marrëveshjes për Kycje KOSTT-ENTSO-E.

- Serbia ka parashtruar katër kërkesa për regjistrimin e kompanisë 'Elektrosever' (furnizuesi i energjisë elektrike për pjesën veriore të Kosovës), e cila nuk ishte në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative të Kosovës.
- Aplikacionet e tilla u refuzuan nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës për shkak të mospërputhjes me kornizën ligjore dhe rregullative të Kosovës.
- Statuti i 'Elektrosever' nuk ka theksuar dispozitat e ligjeve të Kosovës, por ka theksuar dispozitat e ligjeve të Serbisë.
- Statuti nuk ka përcaktuar vendin e funksionimit të kompanisë, por nënkupton se ajo është Serbia.
- Marrëveshja për Kycje KOSTT-ENTSO-E nuk ka hyrë në fuqi për shkak të kushteve të padrejta për regjistrimin dhe licencimin e kompanisë 'Elektrosever'.
- KOSTT po pëson humbje të konsiderueshme financiare për shkak të mos hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për Kycje.
- KOSTT ka marrë pjesë në dhjetëra takime të organizuara nga ENTSO-E në këtë fushë por nuk është arritur asnjë rezultat.
- Bazuar në Raportin e Avokatin e Popullit të Kosovës, Gjykata Themelore e Kosovës/Prishtinës ka ndërprerë subvencionimin e mëtejshëm të energjisë elektrike për konsumatorët në veriun e Kosovës, e cila që nga fundi i luftës së vitit 1999 nuk ka paguar për energjinë e konsumuar. Ky konsum i energjisë elektrike ishte mbuluar nga pjesa tjetër e popullsisë së Kosovës përmes tarifës së energjisë elektrike.
- Kjo e fundit ka shkaktuar devijime të paqëllimshme në sistemin energjetik të Evropës kontinentale, që po vazhdon edhe aktualisht.

### **Progresi i KOSTT në hapjen / zbatimin e Pakos së Tretë të tregut**

- Tregu i shitjeve me shumicë dhe pakicë (hapja e plotë e tregut të shitjes me pakicë - faza e fundit 1 prill 2018),
- Mekanizmi i balancimit ekziston që nga qershori i vitit 2017,

- KOSTT dhe OSSH prokurojnë humbjet e rrjetit në një treg të hapur (edhe në bazë të D-1),
- KOSTT do të jetë aksionare e SHRR-it të Shqipërisë dhe planifikon të lidhë tregjet me Shqipërinë - projekt i mbështetur nga EnCS përmes iniciativës WB6,
- KOSTT ka përfunduar shturjen e pronësisë dhe ka dorëzuar aplikacionin për certifikim pranë Zyrës së Rregullatorit,
- KOSTT ka nënshkruar Marrëveshjen ndër-OST me OST-të fqinje
  - Marrëveshjet nuk mbulojnë çështjet e ZK, caktimin dhe llogaritjen e BK-së
- Më datë 01.10.2015, KOSTT ka nënshkruar marrëveshjen e Kycjes (MK) me 30 OSSH të Evropës Kontinentale
  - Zbatimi i MK-së është bllokuar për shkak të faktit se kompania e Serbisë nuk ka aplikuar në mënyrë të rregullt për regjistrimin e kompanisë
- KOSTT është pjesë mekanizmit të ITC-së në ENTSO-E që nga janari i vitit 2016

### **Sfidat dhe pengesat në zbatimin e Marrëveshjeve për Energji dhe Marrëveshjes për Kycje KOSTT/ENTSO-E**

Mos zbatimi i Marrëveshjes për Kycje KOSTT/ENTSO-E po i pamundëson KOSTT-it në:

- Përbushjen e detyrimeve sipas Ligjit për Energji Elektrike dhe Licenca.
- Përbushjen e detyrimeve sipas Direktivës së KE dhe Traktatit të Komunitetit të Energjisë
  - Në përbushjen e objektivave të saja për të siguruar: cilësi të shërbimeve për pjesëmarrësit e tregut, qasje transparente dhe jo-diskriminuese të palëve të treta, si dhe avancim të pozicionit të saj në rajon:
- Shfrytëzimi i linjës së re të interkoneksionit 400 kV ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, nga qershori i vitit 2016
  - Shfrytëzimi i infrastrukturës për sigurimin e rezervës sekondare nga OST (OST i Shqipërisë) dhe balancimi i sistemit - projekti LFC.
  - Parandalimi i KOSTT-it për të përbushur obligimet për Koordinim Rajonal të Sigurisë.
  - Parandalimi i KOSTT që të merr shërbime nga CAO (zyrat rajonale për llogaritjen e kapaciteteve dhe alokimin e kapaciteteve).
  - Krijimi dhe funksionimi si Zonë e Tregut të Ofertimit.
  - Pjesëmarrja e barabartë në Ballkanin Perëndimor 6 (WB6) - Procesi i Berlinit,
    - Hapja e tregut të Energjisë Elektrike,

- Krijimi i tregut të Energjisë Elektrike një ditë para, dhe
- bashkim me tregun një ditë para të vendeve fqinje,
- Tregu i Balancimit Rajonal.
- Themelimi i SHE (PX) me Shqipërinë
- Mundësimi i funksionimit të KOSTT si Zonë/Blok i Kontrollit, respektivisht Zonës së Veçantë të Ofertimit

## Marrëveshja për Telekomunikacionin

### *Progresi*

Autoriteti Rregullator për Komunikimet Elektronike dhe Postare të Kosovës (Autoriteti-ARKEP) është autoriteti përgjegjës në Kosovë për rregullimin e komunikimeve elektronike dhe postare. Autoriteti gjithashtu është përgjegjës për zbatimin e shumicës së aktiviteteve në emër të palës kosovare lidhur me marrëveshjen e Brukselit mbi telekomunikacionet, bazuar në Marrëveshjet e Telekomunikacionit (të datës 3 Shtator 2013), Planet e Përbashkëta të Veprimit për Telekomini (nëntorit të vitit 2015), dhe Përfundimet e Facilitatorit të BE-së për Telekomini (të datës 13 dhe 18 nëntor 2016). Marrëveshja për telekomunikacion parashikon detyrime nga të dyja palët:

- Kodi 383 i telefonisë për Kosovën është alokuar nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (i përfunduar më 15 dhjetor 2016). Në përputhje me Marrëveshjen e Telekomit dhe Planin e Veprimit, Kosova është duke përparuar në procesin e zbatimit të kodit të saj shtetërorë E.164: 383 së bashku me kodet e tjera E.212: 221 dhe Q.708 (SANC): 7-214, të caktuar nga ITU më 15 dhjetor 2016.
- Në shkurt të vitit 2017, ARKEP ka miratuar Planin e Migracionit për zbatimin e kodeve të lartpërmendura, duke përfshirë aktivitetet dhe afatet kohore. I gjithë procesi i zbatimit të kodit të ri E.164: +383 duhet të përfundojë deri më 1 qershor të vitit 2018. Pas kësaj date të gjitha kodet ekzistuese (aktualisht +377, +381 dhe +386) që përdoren nga rrjetet e telefonisë fikse dhe mobile duhet të mos jenë më aktiv në Kosovë për thirrjet ndërkombëtare në Kosovë.
- Kosova ka zbatuar plotësisht autorizimin e përkohshëm, me një domen të kufizuar siç përcaktohet nga marrëveshja, për ofrimin e shërbimeve të telefonisë mobile në Kosovë (dhjetor 2016);
- Një kompanie serbe në Kosovë (që nga dhjetori i vitit 2016) i është dhënë licenca (autorizimi) e plotë për ofrimin e shërbimit të telefonisë fikse);
- Në përputhje me Rekomandimin e ITU-së E.129, më 15 mars 2017, ARKEP i ka paraqitur ITU-së (Byroja e Standardizimit të Telekomunikacionit - TSB) Planin Kombëtar të Numeracionit në formatin e standardizuar të ITU-së (Ref. Nr.Prot.232 / 2/17).
- Pas një sërë korrespondencash midis ITU-së dhe ARKEP-it, më 1 maj 2017, ITU në Buletinin e saj Operativ (Ref. Nr.1123) ka publikuar Planin Kombëtar të Numeracionit të Kosovës, Lista e kodeve ISPC/MNC të caktuara për operatorët nga ARKEP-i dhe Kodin e ri të sinjalizimit/rrjetit (SANC): 7-213 për Kosovën. Në maj të vitit 2017, Kosova është futur si vend i veçantë në bazën e të dhënave e ITU për Kodet shtetërorë (ju lutemi shihni linkun): <http://www.itu.int/oth/T0202.aspx?parent=T0202>.



- Më 11 maj 2017, ARKEP i ka dërguar ITU-së një njoftim zyrtar lidhur me miratimin e Numrave të Identifikuar të Lëshuesve (IIN) 89 383 01 (Telekomi i Kosovës) dhe 89 383 02 (IPKO Telecommunications LLC) për operacione mobile. Deri më tani, këto kode nuk janë publikuar ende nga ITU. Në reagimin e ITU, ata sugjeruan që kjo çështje të diskutohet me Serbinë. Për informacionin tuaj tarifat për këto kode paguhen tashmë nga operatorët, dhe ITU është njoftuar për këtë.
- INN është një kod teknik i nevojshëm për printimin e SIM kartelave të operatorëve të telekomit, ku numri 89 nënkupton Telekomit në nivel global dhe tërë pjesa tjetër e kodit lidhet me 383. (referenca relevante në ITU: <http://www.itu.int/rec/T-REC-E.118-200605-I>).
- Në përputhje me Planin e Veprimit për Zbatimin e Marrëveshjes (Pika referuese 3), ARKEP ka lëshuar autorizimin për ndërmarrjen "mts" D.O.O. të regjistruar në ARBK në pajtim me Kornizën Ligjore të Republikës së Kosovës. ARKEP ka lëshuar Autorizim të Përgjithshëm (Letër Konfirmimi në përputhje me regjimin e përgjithshëm të autorizimit) për ndërmarrjen "mts" D.O.O. për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse. ARKEP ka ndarë gjithashtu blloqe gjeografike të numërimit për përdorim nga ndërmarrja "mts" D.O.O. për ofrimin e shërbimeve të telefonisë fikse në territorin e Republikës së Kosovës.
- Në vazhdim e sipër janë negociatat ndërmjet Telekomit të Kosovës dhe "mts" D.O.O. (Interkoneksioni Kombëtare) dhe Telekomit të Kosovës dhe Telekomit të Serbisë (Interkoneksioni Ndërkombëtarë). Ato pritet të përfundojnë së shpejti.

### *Sfidat*

- Duke marrë parasysh progresin e arritur në zbatimin e kodit shtetërorë 383, si dhe sfidat me të cilat ballafaqohen operatorët, ARKEP me Vendimin nr. 1189 ka zgatur afatet për zbatimin e kodit 383. Deri më 31 tetor 2018, i tërë procesi i zbatimit të kodit të ri E.164: +383 duhet të përfundojë në rrjetet mobile. Brenda 30 ditësh, operatorët e rrjetit fiks duhet të përfundojnë procesin e zbatimit të kodit 383 dhe të çaktivizojnë kodin 381.
- Zbatimi i Kodit Shtetëror të telefonisë mobile MCC: 221 duhet të përfundojë plotësisht deri më 31 dhjetor 2018.
- Marrëveshjet midis rregullatorëve ende janë në pritje të harmonizimit të përdorimit të spektrit të frekuencave, me qëllim të sigurimit të ofrimit reciprok të pandërprerë të shërbimeve, bazuar në parimet e ITU dhe shmangien e ndërhyrjeve të dëmshme midis shërbimeve. Rregullatori i Kosovës është gati të vazhdojë.
- Është bërë përparim i kufizuar në marrëveshjet e romingut midis operatorëve, me qëllim të uljes së tarifave të përdoruesve. Deri në një masë është shënuar progres nga operatorët individualë.

- Nuk është bërë progres sa i përket marrëveshjeve teknike ndërmjet rregullatorëve kombëtarë për koordinimin/harmonizimin e frekuencave ndërkufitare për transmetimet tokësore mobile dhe digjitale.

## **PUNA PËR ZBATIM NË PERIUDHËN MARS 2011 - SHKURT 2012 NË LIDHJE ME MARRËVESHJET E DIALOGUT TEKNIK**

### **Çështjet doganore**

#### ***Progresi***

#### ***I. PËRFUNDIMET E DAKORDUARA MBI VULAT DOGANORE / TREGTINË E LIRË, 02 SHTATOR 2011,***

- Tregtia e lirë ndërmjet dy palëve është mundësuar përmes njohjes së ndërsjellë të vulave doganore në vitin 2011. Marrëveshja parashikonte tregtinë e lirë të ndërsjellë dhe përfundimin e embargos së Serbisë ndaj eksporteve të Kosovës.
- Dogana e Kosovës ka zbatuar në mënyrë efektive të gjitha obligimet që rrjedhin nga kjo marrëveshje.
- Serbia shkel marrëveshjen duke përdorur ende vulat paralele doganore (vulat doganore serbe me emërtimet e qyteteve të Kosovës).
- Dëshmitë lidhur me këtë problem të vazhdueshëm në pikën kufitare Merdare dhe Dheu i Bardhë po regjistrohen në baza ditore. Serbia duhet ta respektojë marrëveshjen dhe t'i shfuqizojë strukturat dhe vulat e saj paralele doganore.
- Grafiku i Autoriteteve Serbe Doganore (zyrat doganore) ende e përfshin Prishtinën si zyrën e tyre doganore. Linku në vijim mund të ofrojë informata shtesë për strukturën organizative <http://www.carina.rs/lat/ONama/organizacija/Stranice/Osnovna.aspx>.
- Vulat joligjore përdorin mbishkrimet “CarinarnicaPristina” (dega e Doganës së Prishtinës) dhe është nën degën e Doganës së Nishit. Rrjedhimisht mund të shihet që Serbia nuk po respekton Marrëveshjen për njohje të ndërsjellë të vulave doganore të arritur më 2 shtator 2011. Përveç kësaj, Serbia shkel rregullat e CEFTA ku palët kanë rënë dakord që të përdorin vulat e konfirmuara për të gjithë anëtarët e CEFTA-s.
- Pala e Kosovës ka ngritur vazhdimisht këtë çështje me ç'rast ka kërkuar nga Serbia që ta respektojë Marrëveshjen për vulat doganore të lidhur në vitin 2011 në kuadër të grupit punues të MIK. Serbia në mënyrë retorike premtoi që ta zbatonte, por nuk arriti të bënte një gjë të tillë në praktikë. Për më tepër, lidhur me këtë çështje janë arritur shumë përfundime, të cilat Serbia nuk i ka zbatuar asnjëherë.

## ***II. MARRËVESHJA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE DOGANORE E DATËS 17 JANAR 2013***

- Marrëveshja për arkëtimin doganor e arritur në janar të vitit 2013 në Bruksel, parasheh arkëtimin e detyrimeve doganore nga Dogana e Kosovës në PKK Jarinje dhe Bërnjak, që ishte bllokuar për shumë vite nga pala serbe.
- Zbatimi i kësaj marrëveshjeje po ecë shumë mirë dhe gjatë kësaj periudhe nuk është identifikuar ndonjë pengesë e madhe.
- Pas Marrëveshjes për arkëtim doganor në dy kalimet kufitare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, Jarinje dhe Bërnjak, e cila është arritur më 17 janar 2013 dhe ka filluar të zbatohet në dhjetor të vitit 2013, në PKK-të Jarinje dhe Bërnjak deri më tani janë arkëtuar mbi 14 milion euro për Fondin e Zhvillimit.
- Fondi i Zhvillimit është themeluar për të promovuar zhvillimin socio-ekonomik dhe për të përfituar popullata lokale në komunën e Leposaviqit, Mitrovicës veriore, Zubin Potokut dhe Zveçanit. Funkcionimi i Fondit përcaktohet nga Bordi Drejtues, i cili është i përbërë nga Kryesuesi i Zyrës së BE-së, Ministri i Financave i Kosovës dhe një përfaqësues i komunitetit serb.

## ***III. MARRËVESHJA SEED (SHKËMBIMI SISTEMATIK ELEKTRONIK I TË DHËNAVE DOGANORE) ROMË, ITALI, 24 JANAR 2013***

- Kjo marrëveshje është lidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë me qëllim të shkëmbimit të të dhënave ndërmjet autoriteteve doganore përkatëse (deklarata të importit, transitit ose eksportit, përfshirë TIR dhe ATA).
- Pala kosovare, që nga viti 2013, ka qenë shumë aktive dhe serioze në themelimin e mekanizmave për shkëmbimin e informatave me Serbinë në lidhje me funksionimin më të mirë të MIK. Që atëherë, Dogana e Kosovës i ka ndërmarrë të gjitha masat për shkëmbimin e informatave nëpërmjet përdorimit të iniciativës rajonale të krijuar nga BE për Shkëmbimin Sistematik Elektronik të të Dhënave (SEED).
- Dogana e Kosovës ka zbatuar këtë marrëveshje që nga viti 2013, ndërsa Serbia ka shtyrë zbatimin e saj deri në fund të vitit 2015.
- Nga ana tjetër, pala serbe ka shtyrë zbatimin e marrëveshjes deri në nëntor 2015.
- Bashkëpunimi në këtë fushë ndihmon në kontrollin më të mirë të cilësisë së eksportit dhe importit të mallrave ndërmjet të dy vendeve.

## ***IV. LICENCIMI DHE REGJISTRIMI I MALLRAVE TË KONTROLLUARA PËR KOMPANITË QË OPEROJNË NË VERI TË KOSOVËS***

- Deri më tani nuk është raportuar ndonjë problem apo pengesë. Të gjitha informatat e përpunimit nga sistemi ASYCUDA kalojnë direkt tek Zyra e Administratës Tatimore, me qëllim të informimit.
- Në sistemin e Doganave të Kosovës janë të regjistruara mbi 500 kompani për eksport dhe import të mallrave nga katër komunat veriore dhe i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga këto kompani në Doganën e Kosovës është në përputhje me ligjin e Kosovës.
- Marrëveshja për CPF (certifikatat e produkteve farmaceutike) është arritur gjatë dialogut në Bruksel më 27 qershor të vitit 2015. Marrëveshja parasheh njohjen e ndërsjellë të Certifikatave për Produkte Farmaceutike ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Serbisë, gjë që ndihmon në normalizimin e tregtisë në fushën e produkteve mjekësore ndërmjet dy vendeve.
- Zbatimi i Marrëveshjeve të Brukselit nuk ka ndihmuar vetëm në vendosjen e sundimit të ligjit në këtë fushë dhe zvogëlimin e ekonomisë joformale, por ka ofruar gjithashtu një burim shtesë për investime për zhvillim në pjesën veriore, për të cilën Qeveria e Kosovës vazhdon të angazhohet.

### ***Pjesa 2: Sfidat në zbatimin e marrëveshjeve***

- Pengesat e Serbisë në ndërtimin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar sipas marrëveshjeve
- Serbia duhet të respektojë marrëveshjen dhe të shfuqizojë strukturat dhe vulat e saj paralele doganore (vulat doganore serbe me emërtimet e qyteteve të Kosovës).
- Përveç kësaj, Serbia ende pengon qytetarët nga vendet e treta që të hyjnë në Serbi nga Kosova, pavarësisht faktit se Kapitulli 35 i BE i bën thirrje Serbisë që ta zgjidhë këtë çështje.
- Anulimi i të gjitha takimeve të MIK nga Serbia në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

### ***Pjesa 3: Propozimet për përmirësimin e zbatimit të marrëveshjeve***

- Serbia duhet t'i shfuqizojë strukturat dhe vulat e saj paralele doganore (vulat doganore serbe me emërtimet e qyteteve të Kosovës).

## MIK-u dhe pikat e përbashkëta të kalimit kufitar

### *Pjesa 1: Progresi i arritur*

Në përputhje me Protokollin Teknik të IBM-së dhe detyrimet tjera që rrjedhin nga marrëveshjet e IBM-së, Qeveria e Kosovës ka zbatuar në mënyrë efektive të gjitha detyrimet.

### *Progresi për ndërtimin e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar*

- Pika e përhershme e përbashkët e kalimit kufitar në Merdare pothuajse është përfunduar. Gjatë këtij procesi ka pasur shumë pengesa nga pala serbe, të tilla si: vendimi për të mos shpronësuar tokën ku ishte paraparë të ndërtohej parkingu, parking i cili u ndërtua më pas në anën e Kosovës; vonesat në përgjigjen ndaj kërkesave; vendimi për t'u mos zhvendosur në ndërtesat e reja administrative, gjë që ishte paraparë të bëhej në muajin maj, etj. Pika e kalimit kufitar do të hapet në fund të shtatorit ose fillimit të tetorit 2018;
- Pika e përhershme e përbashkët e kalimit kufitar në Mutivoda është gjithashtu afër përfundimit. Kjo pikë e kalimit kufitar do të hapet në fund të shtatorit ose fillimit të tetorit 2018;
- Lidhur me pikën e përhershme të kalimit kufitar në Bërnjak, Qeveria e Kosovës ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të filluar me zhvendosjen e shtyllave elektrike, megjithatë, Komuna e Zubin Potokut dhe Elektro-Kosmet, nën presionin e drejtpërdrejtë të Serbisë, kanë vonuar procesin. Kështu, ndërtimi i pikë kalimit kufitar nuk kishte filluar.
- Pika e përkohshme e kalimit kufitar në Kapi përfundon në prill 2018. Ndonëse gjatë takimit në muajin mars të dy vendet dhe BE u pajtuan t'i hapin pikat e kalimit kufitar Kapi dhe Izvor (në territorin serb), në prill të vitit 2018, Qeveria e Serbisë ka refuzuar ta organizojë vizitën në terren për të dyja pikat dhe t'i hapë pikat e kalimit kufitar.

### *Progresi i arritur nga Policia e Kosovës*

- Sigurimi i numrit të balancuar dhe proporcional të zyrtarëve policorë serb në pikë kalimet në Serbi;
- Zbatimi efikas i mandatit të EULEX-it në kontrollin kufitar;
- Themelimi i grupit punues për zbatimin e marrëveshjeve për MIK;
- Zbatimi efikas i standardeve për kontroll kufitar;

- Përvijimi i zonës së kontrollit kufitar në përputhje me kërkesat operative të kontrollit kufitar;
- Zbatimi i kontrollit të lehtësuar të komunikacionit në pikë kalimet kufitare, kurdo është e nevojshme;
- Shkëmbimi i vazhdueshëm i informacioneve me autoritetet serbe për MIK nëpërmjet kanaleve të dakorduara;
- Organizimi dhe pjesëmarrja në takimet e rregullta lokale, rajonale dhe qendrore;

#### *Progresi i arritur nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë*

- Njohja bilaterale e 1 certifikate të fitosanitarisë;
- Njohja bilaterale e 9 certifikatave të veterinarisë;
- Shkëmbimi i listave të operatorëve ekonomik/prodhuesve të ushqimit;
- Shkëmbimi i rregullt i informacioneve me Agjencinë Serbe të Ushqimit dhe Veterinarisë në fushën e sigurisë ushqimore, luftimit të sëmundjeve të kafshëve dhe bimëve dhe në parandalimin e përhapjes së sëmundjeve;
- Pjesëmarrja e rregullt në të gjitha takimet lokale, rajonale dhe qendrore.

#### *Progresi i arritur nga Doganat e Kosovës*

- Doganat e Kosovës janë duke zbatuar plotësisht Marrëveshjen për MIK dhe Protokollin Teknik, Planin e Veprimit të MIK të vitit 2012 dhe përfundimet tjera të dakorduara si marrëveshja e parë e nënshkruar ndërmjet dy vendeve, duke mundësuar vendosjen e kufirit ndërshtetëror ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- Ka lejuar rivendosjen e autoriteteve shtetërore të Kosovës në dy pikë kalime kufitare në Jarinjë dhe Bërnjak, që gjenden në pjesën veriore të kufirit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

#### *Pjesa 2: Sfidat në zbatimin e marrëveshjes*

Mos ndërtimi i pikë kalimeve të përbashkëta kufitare në territorin e Serbisë

- Nuk është arritur progres nga Qeveria e Serbisë për 2 vite në ndërtimin e 3 pikë kalimeve të përhershme në Jarinjë, Dheu i Bardhë dhe Muçibabë. Në takimin e parë të mbajtur në Bruksel më 26 shkurt të vitit 2018, Qeveria e Serbisë u dakordua që të ofrojë në takimin e dytë datën për lansimin e ndërtimit të 3 PKK-ve; megjithatë, gjatë takimit të dytë të mbajtur më 22 mars, delegacioni i Serbisë refuzoi ofrimin e datës.
- Refuzimi i Serbisë për organizimin e vizitave në terren në pikë kalimet e përkohshme në Izvor (në Serbi) dhe Kapi (në Kosovë) dhe hapjen e tyre, përkundër dakordimit gjatë dy takimeve të fundit në Bruksel.

#### *Sfidat me të cilat është përballur Policia e Kosovës*

- Anulimi i takimeve lokale, rajonale dhe qendrore nga Serbia;

- Serbia nuk ka ndarë dhe shkëmbyer informata në fushën e kontrollit kufitar;
- Serbia nuk ka zbatuar kontroll të lehtësuar të kufirit gjatë flukseve të trafikut në pikë kalimet kufitare;

#### *Sfidat e hasura nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë*

- Njohja bilaterale e certifikatave të veterinarisë për produktet tjera, si mishin e shpezëve, vezët, qumështin, peshqit, etj.
- Shkëmbimi në kohë reale i informacioneve në fushën e sigurisë ushqimore, shëndetit të kafshëve dhe bimëve nëpërmjet programeve elektronike për kontroll kufitar sipas modelit "TRACES" që përdoret në BE;
- Ndërtimi i infrastrukturës sipas standardeve të BE për zbatimin e inspektimeve të veterinarisë dhe fito-sanitaris;
- Zbatimi i praktikave më të mira të BE në inspektimet e veterinarisë dhe fito-sanitaris.

#### *Sfidat e hasura nga Doganat e Kosovës*

- Pengesat e Serbisë në ndërtimin e pikë kalimeve të përbashkëta sipas marrëveshjeve
- Serbia duhet të respektojë marrëveshjen dhe të shuajë strukturat dhe vulat e saj doganore paralele (vulat doganore serbe me emërtime të qyteteve të Kosovës).
- Përveç kësaj, Serbia akoma pengon qytetarët e vendeve të treta që të hyjnë në Serbi nga Kosova, përkundër faktit që kapitulli 35 i BE-së i bënë thirrje Serbisë që ta zgjidhë këtë çështje.
- Anulimi i të gjitha takimeve për MIK nga Serbia në nivel lokal, rajonal dhe qendror.

#### *Pjesa 3: Rruga që duhet ndjekur*

- Serbia duhet të iniciojë ndërtimin e 3 pikë kalimeve të përhershme pa vonesa të mëtejshme, siç është dakorduar me marrëveshjet për MIK;
- Serbia duhet të ndalojë presionin në Komunën e Zubin Potokut. Si pasojë e presionit të Serbisë nuk është iniciuar ndërtimi i pikë kalimeve të përhershme në Bërnjak.
- Serbia duhet të rifillojë pjesëmarrjen dhe organizimin e takimeve lokale, rajonale dhe qendrore.
- Serbia duhet të ndërpres ndalimin e jashtëligjshëm dhe marrjen në pyetje të të zyrtarëve policorë dhe zyrtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës kur udhëtojnë në Serbi. Që nga muaji prill, 6 zyrtarë (3 zyrtarë të KP dhe 3 zyrtarë të FSK) janë ndalur dhe marrë në pyetje nga shërbimet sekrete të Serbisë.
- Serbia duhet të ndalojë refuzimin e pajustificuar dhe të jashtëligjshëm të hyrjes së kosovarëve në Serbi. Serbia ka refuzuar hyrjen e një delegacioni prej 30

personave nga Federata e Karatesë së Kosovës, të cilët po udhëtonin nëpër PKK Medare për të marrë pjesë në Kampionatin Evropian të Karatesë në Novisad të Serbisë.

- Serbia duhet të ndalojë keqtrajtimin e personave që udhëtojnë në Serbi. Autoritetet serbe kanë refuzuar futjen e një numri të fotografive dhe katalogëve të artistëve kosovarë, të cilët po shkonin të merrnin pjesë në festivalin vjetor “Mirdita, DobarDani” në Beograd, i cili ka për qëllim nxitjen e shkëmbimeve kulturore ndërmjet artistëve të të dyja vendeve.

#### *-Policia e Kosovës*

- Rifillimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informatave në fushën e kontrollit kufitar;
- Rifillimi i aplikimit të kontrollit të lehtësuar doganor kur është e nevojshme, dhe veçanërisht gjatë sezonës së verës;

#### *-Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë*

- Ndërtimi i infrastrukturës sipas standardeve të BE-së për zbatimin e inspektimeve të veterinarisë dhe fitosanitarisë;
- Aplikimi i sistemeve elektronike sipas modelit të BE-së “TRACES”.

#### *-Doganat e Kosovës*

- Serbia duhet të shuajë strukturat dhe vulat e saj paralele doganore (vulat doganore serbe me emërtime të qyteteve të Kosovës).



## Liria e lëvizjes

### *Pjesa 1: Progresi i arritur*

Qeveria e Kosovës ka vazhduar zbatimin e obligimeve që dalin nga liria e lëvizjes dhe mbetet e përkushtuar për këtë proces.

- Më 1 mars 2017, qeveria mori vendimin (nr. 05/134) duke lejuar pajisjen me dokumente të shtetësisë dhe gjendjes civile për qytetarët që figurojnë në Regjistrat e Gjendjes Civile, por që ende nuk i kanë marrë dokumentet e Kosovës. Paragrafi i dytë i vendimit thekson që me qëllim të realizimit të kësaj të drejte, qytetarët që aplikojnë për dokumente të shtetësisë dhe gjendjes civile dhe janë në regjistrin civil të Kosovës, duhet të disponojnë me dokumentet e vjetra që vërtetojnë identitetin e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi;
- Më 14.07.2017 është nënshkruar Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2017 për kriteret që përbëjnë dëshmi për shtetësinë e Ish-RFJ-së dhe banimin e përhershëm në territorin e Kosovës më 1 janar 1998, sipas të cilit kompetencat për regjistrimin e shtetësisë, në bazë të nenit 32 të ligjit për shtetësinë, i janë transferuar nivelit komunal. Ky ndryshim krijon qasje më të lehtë në dokumentet e gjendjes civile dhe regjistrimin e shtetësisë në të gjitha komunat;
- Infrastruktura administrative për lëshimin e dokumenteve është plotësisht funksionale në komunat veriore. 32 ish-pjesëtarë administrativ të policisë janë integruar në zyrat e Agjencisë së Regjistrimit Civil në komunat veriore;
- Është siguruar një numër i përgjithshëm prej 300, 000 shiritave dhe zbatimi i shiritave në targat e regjistrimit është gati, kurdo që arrihet dakordimi në Bruksel;
- Në bazë të vendimit nr. 18/35 të datës 09.03.2018, Qeveria miratoi proceset e rekrutimit të 39 anëtarëve të ish-stafit administrativ të MUP-it në Zyrat e Gjendjes Civile dhe kërkoi nga Ministria e Financave t'i sigurojë burimet financiare;
- Më 15 dhjetor të vitit 2017, Ministri i Punëve të Brendshme vendosi të zgjasë periudhën e aplikimit për ndryshimin e patentë shoferëve dhe shtimin e kategorive në patentë shoferët e Kosovës nga patentë shoferët e lëshuar nga organet serbe deri më 14.09.2016; vendimi është i vlefshëm deri më 30 qershor 2018;
- Gjithsej 4105 patentë shoferë u janë dhënë shtetasve serbë prej 12 dhjetorit 2017 deri më 31 maj 2018.

- Tabela e mëposhtme ofron statistika të përgjithshme për periudhën deri më 13 qershor 2018:

#### Pasaporta

Komuna	Numri
Mitrovicë e Veriut	1332
Leposaviq	398
Novobërdë	1725
Graçanicë	2695
Shtërpcë	5937
Z. Potok	700
Zveçan	488
Partesh	743
Klllokot	1059
Numri total	<b>15,077</b>

#### Letërnjoftime

Komuna	Numri
Mitrovicë e Veriut	13231
Leposaviq	10785
Novobërdë	7011
Graçanicë	15358
Shtërpcë	12549
Z. Potok	6002
Zveçan	6501
Partesh	2972
Klllokot	2450
Numri total	<b>76,859</b>

#### Patentë shoferë

Komuna	Numri
Mitrovicë e Veriut	1520
Leposaviq	1259
Novobërdë	2010
Graçanicë	4434
Shtërpcë	4323
Z. Potok	995
Zveçan	761
Partesh	720
Klllokot	627
Numri total	<b>16,649</b>

- Udhëzimi i ri Administrativ nr. 02/2018 për regjistrimin e mjeteve me targa KS dhe Udhëzimi Administrativ nr. 01/2018 për regjistrimin e mjeteve janë nënshkruar nga Ministri më 16.03.2018. Me qëllim që qytetarët të motivohen që t'i regjistrojnë automjetet me targa KS ose RKS, më 16.03.2018, Ministri mori vendimin nr. 100/2018 për heqjen e taksave të regjistrimit për pronarët që posedonin automjete me targa të ish-RFJ-së ose me targa të ngjashme nga 10 qershori 1999 deri më 14 shtator 2016. Përveç kësaj, përmes këtij vendimi do të pranohet çdo Certifikatë e Kontrollimit Teknik. Vendimi është i vlefshëm për një vit. Deri më sot, 88 automjete i kanë ndryshuar targat në RKS ose KS;
- Ministri i Punëve të Brendshme përmes vendimit nr. 99/2018 të datës 16.03.2018, zgjati periudhën e regjistrimit të automjeteve me targa RP deri më 15 shtator 2018. Gjatë periudhës janar-maj 2018, për herë të parë u regjistruan 1.885 automjete, për dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar kur u regjistruan 843 automjete.
- Në Mitrovicën e Veriut u hap Qendra për Kontrollimin Teknik të Automjeteve, derisa një kërkesë shtesë u paraqit në Ministrinë e Infrastrukturës për ta hapur

një qendër të tillë edhe në Leposaviq, kërkesë e cila për momentin është duke u shqyrtuar nga MI.

***Pjesa 2: Sfidat në zbatimin e marrëveshjeve***

- Zbatimi i regjimit të shiritave;
- Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile nga strukturat ilegale;
- Mospranimi nga Serbia i dokumenteve të rregullta të lëshuara nga Kosova.

***Pjesa 3: Rruga përpara në përmirësimin e zbatimit të marrëveshjeve***

- Të ndërpritet regjistrimi i automjeteve nga strukturat ilegale;
- Të ndërpritet qarkullimi i automjeteve pa targa në Mitrovicën e Veriut;
- Të krijohet bashkëpunim midis dy agjencive përkatëse të të dy vendeve për ta verifikuar pronësinë e automjeteve;
- Të organizohen fushatave informuese së bashku me komunat veriore dhe BE-në për t'i informuar qytetarët për procedurat e regjistrimit të automjeteve;
- Strukturat ilegale t'ia dorëzojnë Kosovës dokumentet e gjendjes civile për ta kryer procedurën e verifikimit për pranimin e lindjeve, martesave dhe vdekjeve;
- Të ndërpritet praktika e plotësimit të formularëve të "hyrjes dhe daljes" nga shtetasit e Kosovës që udhëtojnë përmes pikë kalimeve kufitare të Serbisë.

### Liria e lëvizjes/Ura e Mitrovicës

Megjithëse kanë kaluar pothuajse tri vjet pas arritjes së kësaj marrëveshjeje, zbatimi i saj i plotë ende nuk ka filluar dhe ende nuk ka liri të lëvizjes në urën "Ibër" në Mitrovicë.

Megjithatë, pak pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, institucionet e Qeverisë së Kosovës ndërmorën të gjithë hapat e nevojshëm drejt krijimit të kushteve për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, më saktësisht:

- U siguruan hartat, që u morën nga zyra e UNMIK-ut në Kosovë, dhe të njëjtat u krahasuan nga autoriteti i Kosovës përgjegjës për këtë çështje - Agjencia Kadastrale e Kosovës.
- U vërtetua se autenticiteti i tyre është në përputhje të plotë me Propozimin Gjithëpërfshirës të presidentit Ahtisari.
- Në pajtim me Ligjin nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ të Komunave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor shpërndau hartat për palët e përfshira dhe përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjes:
  - Kryeministrin e Kosovës
  - Zyrën e BE-së në Kosovë
  - Ish-Ministrinë e Dialogut
  - Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Komunën e Mitrovicës së Jugut, dhe
  - Komunën e Mitrovicës së Veriut.
- Pas verifikimit të këtyre hartave nga Zyra Ligjore e BE-së, kemi përgatitur edhe një draft memorandum të mirëkuptimitsipas Marrëveshjesë Brukselit, që do të nënshkruhet nga palët në vijim:
  - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
  - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
  - Komuna e Mitrovicës së Jugut, dhe
  - Komuna e Mitrovicës së Veriut

Të gjitha këto kanë qenë të gatshme përpara afatit të përcaktuar nga marrëveshja e datës 25 gusht 2015, duke treguar kështu një angazhim serioz të Qeverisë së Kosovës për përmbushjen e obligimeve që dalin nga ky proces, dhe për këtë qëllim, fondet e parapara për zbatimin e obligimeve janë ndarë në buxhetin e MMPH-së.

- Daftmemorandumi i mirëkuptimit u nda me Zyrën e BE-së në Kosovë dhe me Ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, me ç'rastu dakorduum për tekstin, dhe njëkohësisht, me të gjitha palët e mësipërme organizuam takime të shumta për nënshkrimin e memorandumit të mirëkuptimit dhe për fillimin e zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Pas secilit prej takimeve të lartpërmendura përpiluum procesverbalin dhe ia shpërndamë të gjitha palëve.
- Zyra e BE-së në Kosovë, përgjegjëse për rivitalizimin e urës, dështoi t'i përfundojë punimet në terren për shkak të mungesë së bashkëpunimit nga kryetari i Mitrovicës së Veriut (z. Rakiq), i cili duket se i përmbahet udhëzimeve nga Serbia. Nga ana tjetër, kryetari i Mitrovicës së Jugut (z. Bahtiri) ka qenë tejet bashkëpunues.
- Serbia po pengon në këtë aspekt duke mos lejuar që kryetari i Mitrovicës Veriore ta nënshkruajë memorandumin e mirëkuptimit me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, memorandum i cili konfirmon vijën kufitare administrative ndërmjet dy komunave të Mitrovicës në përputhje me ligjet e Kosovës dhe Planin e Ahtisarit.
- Për më tepër, ndërtimi i një muri të lartë 2,3 m dhe të gjatë 50 m, në pikën ku sheshi i këmbësorëve në rr. "Mbreti Petar" në Mitrovicën e Veriut është parashikuar të hapet, është një shenjë e destruktivitetit, ndërsa Qeveria dhe autoriteti qendror kanë penguar një ndërtim të tillë i cili, përveç që ishte në kundërshtim me Marrëveshjen e Brukselit, në të njëjtën kohë ishte në kundërshtim edhe me ligjet e Kosovës, prandaj u nevojitën përpjekje shtesë nga MMPH-ja, Zyra e Kryeministrit, Zyra e BE-së në Kosovë dhe ambasada e SHBA-së në Kosovë që të gjendej një zgjidhje dhe t'i bindin autoritetet lokale të Mitrovicës së Veriut që ta prishin vetë këtë mur në mënyrë që të shmanget përdorimi i forcës për ta bërë këtë.
- Marrëveshja për largimin e këtij muri në Mitrovicën e Veriut u arrit në shkurt të vitit 2016, dhe më vonë ky mur vërtetë u largua, por sigurisht ndikoi në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit.

### ***Përfundim:***

#### **Pika 5 e Marrëveshjes së Brukselit të 25 gushtit parasheh si në vijim:**

Largimi i barrikadave në urën e lumit Ibër në Mitrovicë dhe rivitalizimi i urës së hapur për këmbësorët, çiklistët dhe automjetet;

Mbyllja e rrugës "Mbreti Petar" në Mitrovicën e Veriut dhe shndërrimi i saj në shesh të këmbësorëve;

Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet MMPH-së, MAPL-së, Mitrovicës së Jugut dhe Mitrovicës së Veriut në lidhje me hartimin e "Planeve Zhvillimore Komunale, Hartave të Zonimit Komunal dhe Planeve Rregulluese të Detajuara" për të dyja anët e brigjeve të lumit Ibër në Mitrovicë.

Të gjitha këto obligime janë përmbushur nga Qeveria e Kosovës, madje edhe kontraktuesit e BE-së, të kontraktuar për të kryer punët sipas marrëveshjeve, i kanë finalizuar ato, megjithatë, procesi ka stagnuar nga ana e Komunës së Mitrovicës së Veriut, ku duhet të punohet më shumë në lidhje me bashkëpunimin me të gjitha palët e tjera të përfshira në zbatimin e marrëveshjeve.

### Për bashkëpunimin rajonal

Ndonëse është vërejtur progres, ekzistojnë probleme sa i përket zbatimit të marrëveshjes për shkak të angazhimit negativ dhe shpesh keqinterpretues të Republikës së Serbisë. Në disa raste, Republika e Serbisë luan rol aktiv me qëllim të përfshirjes së anëtarëve të tjerë të iniciativave dhe organizatave rajonale në çështjet rreth anëtarësimit apo përfaqësimit të Kosovës. Ka raste kur Republika e Serbisë është angazhuar në mënyrë aktive për ta vënë Kosovën në pozitë të vështirë kur vjen puna të përdorimi i simboleve dhe i emrit të saj.

Problemet që vazhdimisht u hasën ishin ato që kanë të bëjnë me agjendën, listën e pjesëmarrësve, ftesat dhe aspekte të tjera që i referohen nevojës për ta përdorur fusnotën, gjë që shpesh i pengoi Kosovës për t'u trajtuar si pjesë e barabartë dhe aktive në këto organizata dhe iniciativa.

Ka shembuj kur këto probleme eskaluan deri në masën që edhe përdorimi i postës elektronike ose i materialeve promovuese siç janë videot gjithmonë i referohej nevojës për fusnotë. Edhe pse këto çështje mund të duken mjaft teknike dhe logjistike, ka raste kur ato pengojnë pjesëmarrjen aktive të Kosovës dhe komunikimin e pandërprerë me palët e tjera në rajon. Ky është edhe një faktor që shpenzon kohë, me pasojë negative në orientimin e Kosovës në bazë të agjendës.

Një problem tjetër është roli i Republikës së Serbisë në inkurajimin e vendeve të tjera që të vënë në pyetje apo të kundërshtojnë të drejtën e Republikës së Kosovës për kryesimin e këtyre organizatave apo iniciativave. Kjo nganjëherë ndikon në procesin e vendimmarrjes, edhe pse në disa raste këto vendime kanë qenë vetëm çështje procedurale.

Republika e Serbisë duhet të përmbahet nga referimi në aspektet teknike, logjistike dhe operacionale të pjesëmarrjes, rolit dhe anëtarësimit të Kosovës në organizatat dhe iniciativat rajonale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për dokumentet jodetyruese, materialet dhe çfarëdo përmbajtje tjetër që nuk prodhon efekte dhe implikime ligjore. BE-ja mund t'ua propozojë ose t'ua ofrojë këtyre organizatave një shënim qartësues në lidhje me frymën marrëveshjes që mundëson pjesëmarrjen aktive dhe të barabartë të Republikës së Kosovës në organizatat, forumet dhe iniciativat rajonale.

### Njohja e diplomave universitare

Më 02.07.2011 në Bruksel u arrit marrëveshja ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë për njohjen e diplomave të arsimit të lartë, marrëveshje e cila hyri në fuqi më 01.01.2012.

Me financim nga Bashkimi Evropian, organizata joqeveritare holandeze SPARK është kontraktuar për ta kryer detyrën e menaxhimit të aspekteve teknike të procesit të njohjes së diplomave, ndërsa Asociacioni Evropian i Universiteteve (EUA) është i përfshirë si autoritet për cilësinë e certifikimit të diplomave.

Aplikacionet iu dorëzuan zyrës së SPARK e cila ishte e vendosur në MASHT. Këto aplikacione janë dërguar në EUA në Bruksel, dhe EUA ka marrë një vendim për njohjen e këtyre diplomave. Pas përfundimit të procedurës, EUA lëshoi një dokument që vërteton autenticitetin e diplomave.

*Në fushën e njohjes së diplomave janë arritur dy marrëveshje:*

- Marrëveshja e parë për diplomat, e arritur në vitin 2011.
- Marrëveshja e dytë për diplomat, e arritur në vitin 2016.

Procesi i verifikimit dhe certifikimit të diplomave, bazuar në marrëveshjen e vitit 2011, filloi më 15 shkurt 2012 dhe vazhdoi deri më 14 qershor 2014.

Kjo fazë e procesit të certifikimit është zhvilluar në katër cikle:

- Cikli i parë i aplikacioneve (shkurt-qershor 2012).
- Cikli i dytë i aplikacioneve (korrik-dhjetor 2012).
- Cikli i tretë i aplikacioneve (janar-qershor 2013).
- Cikli i katërt i aplikacioneve (korrik 2013-shkurt 2014).

**Tabela 1. Aplikacionet për njohjen e diplomave në periudhën shkurt 2012-qershor 2014**

		Aplikacionet e dorëzuara në Prishtinë	Aplikacionet e dorëzuara në Beograd
Numri i përgjithshëm i aplikacioneve të dorëzuara	433	408	25
Numri i aplikacioneve me rekomandim për miratim	387	374	13
Numri i aplikacioneve me rekomandim për	46	30	12

refuzim			
Numri i përgjithshëm i certifikatave të lëshuara		375	362
			13

Më 10 gusht 2015, MASHT-i nxori Udhëzimin Administrativ nr. 9/2015 për parimet dhe procedurat e pranimit të diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave universitare të fituara në territorin e Republikës së Serbisë. Sipas këtij udhëzimi administrativ, certifikatat e lëshuara nga EUA kanë të njëjtën fuqi ligjore dhe barazohen me vendimet e nxjerra nga Këshilli Kombëtar për Njohje, me kusht që ato të përkthehen në një nga gjuhët zyrtare të Kosovës.

Duhet të theksohet se në këtë fazë nuk ishin përfshirë gradat e doktoratës, pavarësisht faktit se marrëveshja nuk i përjashton ato. Arsyet për këtë ishin hezitimet e EUA-së për t'u marrë me këtë nivel të arsimit të lartë. Gjithashtu, diplomat e lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut nuk ishin pjesë e procesit të certifikimit përkundër insistimit të palës serbe. Marrëveshja e vitit 2016 nuk është zbatuar ende, edhe pse palët kanë bërë disa veprime përgatitore në këtë drejtim. Si hap i parë ka qenë shkëmbimi i listës së institucioneve të akredituara të arsimit të lartë, gjë që ka shkaktuar edhe problemin e parë sa i përket zbatimit.

Bashkimi Evropian ka kontraktuar organizatën holandeze SPARK për të ofruar asistencë teknike për njohjen e diplomave të arsimit të lartë, por ky projekt ende nuk ka filluar të zbatohet në mënyrë efektive, kështu që procesi i certifikimit të diplomave mbetet i "ngrirë".

Nuk ka pasur asnjë lëvizje për zbatimin e marrëveshjes në nivelin para-universitar. Sipas raportit të progresit të Qeverisë së Serbisë, ngërçi u shkaktua nga mungesa e fondeve për ndihmë teknike nga Bashkimi Evropian. Gjithashtu, asnjëra palë nuk ka bërë hapa konkretë për ta ndryshuar dhe plotësuar legjislacionin në mënyrë që të fillojnë zbatimin e kësaj pjese të marrëveshjes.

#### **4. Rasti i Universitetit të Mitrovicës së Veriut**

Universiteti i Mitrovicës së Veriut (UMV) është institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Kosovë që ofron të gjithë kurrikulën në gjuhën serbe. Ky institucion është licencuar nga UNMIK në vitin 2007, ndërsa Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, i vitit 2008, e njeh si institucion publik të arsimit të lartë nën autoritetin e drejtpërdrejtë të Komunës së Mitrovicës së Veriut. Megjithatë, ky institucion vazhdon të veprojë brenda sistemit arsimor serb dhe është i akredituar nga autoriteti akreditues i shtetit fqinj.

Qeveria e Serbisë vazhdimisht ka insistuar vazhdimisht që të diplomuarit e universitetit t'i nënshtrohen procesit të njohjes nga organet e Republikës së Kosovës në përputhje me marrëveshjet e Brukselit, por kjo nuk është pranuar nga autoritetet e Kosovës. Në vend të kësaj, autoritetet e Kosovës kanë bërë thirrje për një zgjidhje të veçantë për njohjen e



diplomave të këtij universiteti. Informata të plota për këtë janë dhënë nga Komisioni për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga UMV-ja (në këtë komision, një nga anëtarët e MASHT është zyrtar në NARIC Kosova).

Procesi i verifikimit u parapri nga koncepti dokumenti "Procedurat e aplikimit për vende punë në Institucionet e Republikës së Kosovës për pjesëtarët e Komuniteteve Jo-shumicë që posedojnë Diploma të lëshuara nga UMV-ja", i cili u miratua në mbledhjen e 22-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin nr. 04/22, të datës 03 prill 2015.

Më datën 30 dhjetor 2015, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Rregulloren (QRK) - nr. 21/2015 për Procedurat dhe Kriteret për Lëshimin e Certifikatave Shtetasve të Republikës së Kosovës të cilët kanë marrë diploma nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut, për qëllim të aplikimit për vende pune dhe për marrjen e licencave dhe provimeve profesionale në institucionet publike. Të gjithë qytetarët e Kosovës të cilët kanë diplomuar në Universitetin e Mitrovicës Veriore që nga viti 2001 kanë të drejtë të aplikojnë për marrjen e certifikatave të vlefshmërisë që kanë diplomuar nga Universiteti i Mitrovicës Veriore.

Në pajtim me Rregulloren (QRK) - Nr.21/2015, Qeveria e Republikës së Kosovës, në takimin e mbajtur më 5 shkurt 2016, nxori Vendimin nr. 08/73 për themelimin e Komisionit për Verifikimin e Diplomave të lëshuara nga Universiteti i Mitrovicës së Veriut. Komisioni përbëhet nga katër (4) anëtarë: dy (2) anëtarë të propozuar nga Kryeministri dhe dy (2) anëtarë të emëruar nga Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT). Ndërkohë, me Vendimin nr. 05/144 (04.05.2017), Qeveria e Republikës së Kosovës ka vazhduar mandatin e saj të Komisionit edhe për vite të tjera, sipas ndryshimeve të përcaktuara në Rregulloren (QRK) - Nr.21/2015. Pra, kjo zyrë është aktive në MASHT.

## Mbi kadastrën

Marrëveshja e Brukselit mbi Regjistrat Kadastral e cila u arrit më 2 shtator 2011 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë me lehtësimin e BE-së kërkon kthimin në Kosovë të të gjitha kopjeve origjinale të dokumenteve kadastrale para vitit 1999 të marra nga Serbia gjatë luftës së vitit 1999.

Përfundimet operationale u dakorduan edhe në Bruksel më 21 tetor 2011.

Marrëveshja kërkon nga pala kosovare që të shpall ligjin për themelimin e agjencisë teknike për zbatimin e marrëveshjes, përkatësisht krahasimin e të gjitha kopjeve të të dhënave origjinale kadastrale të pronës private të viteve para 1999, me Kadastrën e Kosovës të rikonstruktuar dhe gjithashtu themelimin e mekanizmit e shqyrtimit në shkallën e parë dhe të dytë. Paralelisht, kërkohet që pala serbe të kryejë skanimin e dokumenteve kadastrale të cilat do të kthehen në Kosovë nëpërmjet Përfaqësuesit Special të Bashkimit Evropian (EUSR).

Kosova tashmë i ka përmbushur obligimet e saj lidhur me themelimin e Agjencisë teknike për zbatimin e kësaj marrëveshjeje:

1. Më 9 qershor 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP).
2. Ligji ishte objekt i ankesës pranë Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të iniciuar nga një grup parlamentar ("Lista Srbska") e përbërë nga anëtarë të parlamentit të komunitetit serb.
3. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj të datës 25 tetor 2016, e shpalli ankesën si të papranueshme duke hapur rrugën për nxjerrjen e ligjit nga Presidenti dhe hyrjen e tij në fuqi në nëntor 2016.

### *Përgatitjet e Agjencisë për zbatimin e ligjit*

1. Pas hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 05/L-010, Agjencia ndërmori një gamë të gjerë veprimesh dhe përgatitjesh për të filluar zbatimin e mandatit të dhënë me Ligjin Nr. 05/L-010.
2. Përveç obligimeve të shumta të përmbushura të fazës së tranzicionit nga ish Agjencia Kosovare e Pronës dhe detyrimeve tjera ligjore që dalin nga ligji i lartpërmendur, Qeveria ka miratuar tre Rregullore dhe dy Udhëzime Administrative për zbatimin e Ligjit për AKKVP-në.
3. Agjencia ka përgatitur një Metodologji të Punës e cila është miratuar nga Bordi Mbikëqyrës për zbatimin e mandatit të tij.

4. Është planifikuar një strukturë e re organizative dhe aktuale e stafit për zbatimin sa më efikas të mandatit të Agjencisë i cili duhet të miratohet nga Bordi Mbikëqyrës.
5. Disa aktivitete informative dhe trajnime u mbajtën me stafin e Agjencisë lidhur me mandatin e ri dhe më shumë planifikohen të mbahen në përputhje me nevojat e identifikuara dhe zhvillimet e tjera në të ardhmen.
6. Agjencia ka zhvilluar takime me institucione të ndryshme, veçanërisht me ato me të cilat në të ardhmen do të ketë një bashkëpunim të ngushtë duke përfshirë Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për t'i informuar ata me mandatin e ri dhe për të krijuar kushte për bashkëpunim gjatë procesit të zbatimit të mandatit.
7. Komisioni për Verifikimin dhe Vendosjen e Pronës (KVVP) përbëhet nga pesë (5) anëtarë. Pas nominimit nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, dy anëtarë të KVVP-së janë emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ndërsa tre (3) tjerë, përfshirë edhe një (1) përfaqësues të komuniteteve jo-shumicë, që do emërohen nga PSBE-ja, nuk janë caktuar ende.
8. Bordi Mbikëqyrës përbëhet nga pesë (5) anëtarë, të cilët ende nuk janë caktuar. Dy anëtarë do të emërohen nga Kuvendi i Kosovës sipas propozimit të Kryeministrit. Tre anëtarë do të emërohen nga PSBE-ja.
9. Pas përgatitjeve të shumta, Agjencia është e gatshme të fillojë zbatimin e ligjit pasi të kthehen dokumentet e skanuara nga Serbia.

### *Sfidat kryesore*

1. Serbia nuk i ka kthyer dosjet kadastrale në Kosovë përmes PSBE siç është paraparë në pikën 3 të Marrëveshjes së Brukselit të 2 shtatorit 2011.
2. I gjithë materiali është skanuar dhe indeksuar dhe Zyra e BE-së në Kosovë ka monitoruar procesin e skanimit në Serbi. Sidoqoftë, pala e kosovare nuk ka informacion se si është bërë skanimi dhe indeksimi.
3. Palët ranë dakord për një plan të ri për zbatimin e marrëveshjes dhe veçanërisht për hartimin e termave të referencës për punën e Grupit të përbashkët trepalësh sipas pikës 8 të Marrëveshjes për Kadastrat të datës 2 shtator të vitit 2011. Këto terma reference nuk janë hartuar asnjëherë dhe rrjedhimisht as nuk janë miratuar nga të tre palët. BE-ja ka pasur një detyrim për të përgatitur draftin e parë.
4. Ndryshimet e supozuara në kornizën ligjore lidhur me kompetencat aktuale ekzekutive të pranisë ndërkombëtare, siç parashihet me Ligjin nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, mund të ndikojë në zbatimin e pikave 5 dhe 6 të Marrëveshjes.

## Bashkëpunimi me EULEX-in Kosovë

Pas një progresi të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm të autoriteteve lokale, përfshirë autoritetet gjyqësore dhe institucionet e tjera, si dhe zhvillimin e aftësive të tyre për të kryer me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e tyre ligjore, është e domosdoshme, e nevojshme dhe një gjetje e përbashkët që misioni aktual i EULEX-it, sidomos pas skadimit të mandatit në qershor 2018, duhet të rishikohet.

Në këtë drejtim, në kuadër të procesit të tranzicionit të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, me iniciativë dhe nën udhëheqjen e Ministrisë së Drejtësisë, u mbajtën disa takime në nivel ministror, si dhe në nivel teknik me akterët kryesorë të Kosovës, fushat ose kompetencat e të cilëve janë ose mund të preken nga tranzicioni i mandatit të EULEX-it.

Po ashtu, EULEX-i krijoi një grup punues për të koordinuar procesin e tranzicionit me institucionet vendore. Janë mbajtur takime në koordinimin e procesit me përfaqësuesit e EULEX-it që janë përgjegjës për tranzicionin e Misionit.

Në këto takime u diskutuan çështje të ndryshme që lidhen me tranzicionin, siç janë:

- qasja në dokumente, materiale dhe dëshmi të institucioneve relevante të Kosovës, me theks të veçantë në qasjen në dokumentet gjyqësore;
- ofrimin e mbështetjes në drejtim të këshillimit dhe monitorimit për institucionet e gjyqësorit, prokurorisë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- dorëzimin e dosjeve, materialeve dhe provave të tjera relevante tek institucionet kompetente të Kosovës;
- çështja e përfshirjes së Njësia Speciale e Policisë (NjSP). Në këtë drejtim, përfaqësuesit e Policisë së Kosovës kanë konstatuar se kjo njësi nuk ka qenë kurrë e përfshirë në mënyrë aktive dhe se PK ka rritur kapacitetet e saja për të mbuluar këto kapacitete. Ata gjithashtu kanë arritur në përfundimin se kjo njësi ka shërbyer për lehtësimin e veprimeve të PK-së, veçanërisht në zonat multi-etnike të Kosovës duke pasur parasysh strukturën organizative dhe kapacitetet e tyre; megjithatë, ata konsideruan vazhdimin e përfshirjes së kësaj njësie si të panevojshme, dhe
- çështja e mbrojtjes së dëshmitarëve, e cila ka të bëjë me vazhdimësinë e mbrojtjes dhe ndërlihdjen me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Në këto takime përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës shprehën angazhimin dhe gatishmërinë e tyre për të marrë përsipër përgjegjësitë e Misionit të EULEX-it në Kosovë.

## **ANGAZHIMET E ARDHSHE TË MISIONIT TË EULEX-it NË KOSOVË**

Pas mbështetjes dhe angazhimit të MISIONIT TË EULEX-it NË KOSOVË (ose emërtimin e mëvonshëm) siç parashikohet në Veprimin e Përbashkët 2008/124/CFSP, miratuar nga Këshilli i Bashkimit Evropian më 4 shkurt 2008, i ndryshuar me Vendimin e Këshillit dhe letrave ndërmjet Presidentit të Republikës së Kosovës dhe Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme, më 4 shtator 2012, 14 prill 2014 dhe 9 qershor 2016, pas procesit të diskutimeve gjithëpërfshirëse dhe takimeve bilaterale ndërmjet institucioneve të Republikës së Kosovës dhe Përfaqësuesit e BE-së, procesi ka rezultuar që misioni i EULEX-it në Kosovë të shpreh angazhimin dhe gatishmërinë e tij për t'u angazhuar në çështjet e mëposhtme:

### **Angazhimi në procesin e monitorimit**

EULEX-i NË KOSOVË është i interesuar që t'i sigurohet qasje në zyra, arkiva dhe dokumente, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, materialet dhe dëshmitë e institucioneve relevante të Kosovës gjatë mandatit të ardhshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Grupi Ndërmintor vlerëson mbështetjen dhe ndihmën e EULEX Kosovë në Monitorimin, Mentorimin dhe Këshillimin (MMK), pasi ndihmon si Gjyqësorin ashtu dhe Prokurorinë në vazhdimin e ngritjes së kapaciteteve të tyre dhe përmbushjen e standardeve evropiane. Angazhimi në MMK i EULEX-KOSOVA sa i përket Prokurorive dhe Gjykatave, pas 15 qershorit 2018, është në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës.

Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se ky komponent duhet të jetë fokusi kryesor gjatë mandatit të ardhshëm të Misionit të BE-së. Komponenti i asistencës dhe MMK duhet të synojë të ngritjen e kapaciteteve të institucioneve qendrore dhe lokale në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga MSA dhe zbatimin e marrëveshjeve të dialogut të përmendura më lart.

Në këtë drejtim, Qeveria e Republikës së Kosovës mirëpret angazhimin e BE për të ndihmuar në ndërtimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të lidhura me zbatimin e suksesshëm të këtyre marrëveshjeve me rëndësi të madhe për realizimin e progresit të Kosovës drejt BE.

Qeveria e Republikës së Kosovës posaçërisht e mirëpret përkushtimin e BE që të rris fondet e IPA që do të ndahen për ndërtimin e këtyre kapaciteteve dhe forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë në përgjithësi.

### **Qasje më proaktive në asistencën teknike**

Misioni i EULEX- KOSOVË kërkon të ketë qasje në fushën e rendit dhe sigurisë publike, si përgjegjësi i dytë i sigurisë; në mbrojtjen e dëshmitarëve dhe në mbështetje të Dhomave të Specializuara si dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar në Kosovë. Punonjësit e policisë së EULEX-it në Kosovë, pas dërgimit të emrave të tyre në Ministrinë e Punëve të Brendshme, të kenë autoritetin të operojnë në nivel qendror (përfshirë ministrinë), rajonal dhe lokal.

Për këtë qëllim, punonjësit e EULEX KOSOVË autorizohen të mbajnë armë, aty ku është e përshtatshme. Sistemi ekzistues i regjistrimit të armëve të mbajtura nga një numër i kufizuar i stafit të autorizuar do të mbahet.

Policia e EULEX-KOSOVË do të vazhdojë të shërbejë në përputhje me ligjin e Kosovës dhe të bashkërendojë dhe të konsultohet ngushtë me Drejtorin e Policisë së Kosovës.

### **Monitorimi, mentorimi dhe këshillimi**

EULEX-KOSOVA do të vazhdojë të mbështesë menaxhimin e lartë të Shërbimit Korrektues të Kosovës duke monitoruar, mentoruar dhe këshilluar dhe do të mbajë një prani në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit me qëllim monitorimin dhe këshillimin për të arritur efektet e dënimeve dhe ri-socializimin e një kategorie të caktuar të dënuar, me theks të veçantë ndaj të dënuarve për veprat terroriste dhe krimin e organizuar.

### **Asistenca teknike në dialogun ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Serbisë**

EULEX KOSOVA do të vazhdojë të ndihmojë në zbatimin e marrëveshjeve të Dialogut të lehtësuar nga BE mes Kosovës dhe Serbisë, derisa kjo kompetencë të transferohet tek akterët e tjerë relevantë të BE.

Bazuar në diskutimet e mbajtura, kërkesat e EULEX-it dhe rekomandimet e institucioneve përgjegjëse në fushat e adresuara, Presidentit i ishte rekomanduar të shkëmbejë letrat me Përfaqësuesine Lartë të Bashkimit Evropian për Punë të Jashtme dhe Politika të Sigurisë.